



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT KLINË

Nr. 117-5137/18

Datë, 30.07.2018

Drejtori i DKA-së: Arben Limanaj

Mbështetur në nenin 8, pika 1, të Ligjit të punës nr. 03/L-212 si dhe në nenin 5, pika c, të Ligjit nr. 03/L 068 për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, Ligjin për Arsim Parauniversitar 04/L-32, Udhëzimin Administrativ 07/2017 (MPMS), si dhe në normativin mbi përzgjedhjen e kuadrit mësimor 10/2018 dhe 5/2015, Drejtoria Komunale e Arsimit në Klinë shpall:

K O N K U R S

Z E V E N D E S I M

Pozita	Shkolla	Orë mësimore	Kohëzgjatja	Fillon punën
Një mësimdhënës për gjuhë Shqipe	SHFMU "Azem Bejta" Grabanicë	20 orë	Deri më 1.11.2018	Pas konkursit
Një mësimdhënës për mësim klasor	SHFMU "Azem Bejta" Grabanicë	20 orë	Me kthimin e mësimdhënës nga pushimi lehonisë	Pas konkursit
Një mësimdhënës për gjuhë shqipe	Gjimnazi "Luigj Gurakuqi" Klinë	20 orë	Me kthimin e mësimdhënës nga pushimi I lehonisë	Pas konkursit
Një edukatore për parafillor	SHFMU "Emin Duraku" "Sferrkë"	15 orë	Deri me kthimin e edukatores nga pushimi lehonisë	Pas konkursit
Një mësimdhënës për fizikë	Gjimnazi "Luigj Gurakuqi" Klinë	20 orë	Me kthimin e mësimdhënës nga pushimi lehonisë	Pas konkursit
Një mësimdhënës për gjuhë angleze	Gjimnazi "Luigj Gurakuqi" Klinë	15 orë	Me kthimin e mësimdhënës nga pushimi lehonisë	Pas konkursit
Një mësimdhënës për mësim klasor	SHFMU "Ismet Rraci" Klinë		Me kthimin e mësimdhënës nga pushimi lehonisë	Pas konkursit
Një mësimdhënës për mësim klasor	SHFMU "Tre Dëshmorët" "Jashanicë"		Me kthimin e mësimdhënës nga pushimi lehonisë	Pas konkursit

VENDE TË LIRA

Pozita	Shkolla	Orë mësimore	Kohëzgjatja	Fillon punën
Një mësimdhënës për TIK	SHFMU "Azem Bejta" Grabanicë	14 orë		Pas konkursit
Një mësimdhënës për Fizikë	SHFMU "Dëshmorët" Volljak	8 orë		Pas konkursit
Një mësimdhënës për mësim klasor	SHFMU "Atë Gjergj Fishta" Jagodë	20 orë		Pas konkursit
Një mësimdhënës për muzikë	SHFMU "Atë Shtjefën Gjeçovi" Zllakuqan	8 orë		Pas konkursit
	SHFMU "Atë Gjergj Fishta" Jagodë	4 orë		Pas konkursit
	SHFMU "Zgjimi" Gremnik	4 orë		Pas konkursit
	SHFMU "Ali Krasniqi" Ujmirë	4 orë		Pas konkursit
	SHFMU "Dëshmorët e Kombit" Qabiq	5 orë		Pas konkursit
	SHFMU "Esad Mekuli", Cerovik			Pas konkursit
	SHFMU "Isa Boletini", Drenoc			Pas konkursit
Një mësimdhënës për mësim klasor	Gjimnazi "Luigj Gurakuqi" Klinë	20 orë	Deri më 31.8.2019	Pas konkursit
Një mësimdhënës për mësim klasor	Gjimnazi "Luigj Gurakuqi" Klinë	20 orë	Deri më 31.8.2019	Pas konkursit
Një mësimdhënës për gjuhë angleze	Gjimnazi "Luigj Gurakuqi" Klinë	20 orë	Deri më 31.8.2019	Pas konkursit
Një mësimdhënës për matematikë	SHMP "Fehmi Agani" Klinë	Njëri me 10 orë	Deri më 31.8.2019	Pas konkursit
Një mësimdhënës për fizikë	SHMP "Fehmi Agani" Klinë	20 orë	Deri më 31.8.2019	Pas konkursit
Dy mësimdhënës për elektroteknikë	SHMP "Fehmi Agani" Klinë	10 orë	Deri më 31.8.2019	Pas konkursit
Një mësimdhënës për matematikë				
Një mësimdhënës për gjuhë gjermane				

KUSHTET:

- Për këto vende të punës kërkohet përgatitja adekuate profesionale (Diploma e Fakultetit përkatës) konform udhëzimit administrativ 10/2018 mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm dhe UA 05/2015 për mësimdhënësit e arsimit profesional.

Përshkrim i detyrave dhe përgjegjësi

Të realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore.

Të përgatisë me rregull planin mësimor vjetor, mujor dhe ditor në përputhje me kurrikulën, e në pajtim me kërkesat për përshtatjen e mësimdhënies aftësive dhe prirjeve individuale të çdo nxënësi. Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet kurrikulare.

Të kontrollojë me rregull dhe të mbajë evidencën për suksesin dhe progresin individual të secilit nxënësi, si dhe të jetë në gjendje të raportojë prindit apo kujdestarit të familjes.

Të marrë pjesë aktive në përgatitjen e programeve dhe aktiviteteve të tjera në shkollë, kur kërkohet nga drejtori i shkollës.

Të kujdeset për zhvillim të vazhdueshëm profesional individual.

I punësuar i është i obliguar të respektojë kodin e veshjes dhe të sjelljes, të përcaktuar me rregulloren e brendshme të shkollës dhe akteve tjera ligjore dhe nënligjore.

Bashkëpunon me organet e shkollës dhe me të gjitha institucionet tjera profesionale.

DOKUMENTACIONI PËR APLIKIM:

Aplikacioni merret në DKA, duke ia bashkëngjitur dokumentet tjera si më poshtë:

- Diploma (certifikata) e fakultetit e fotokopjuar dhe e vertetuar nga organi përkatës juridik – noteri.
- Certifikata e lindjes.
- Letërnjoftimi i fotokopjuar.
- Dokumenti i përvojës së punës në arsim (nëse ka).
- Licencë të mësimdhënies (nëse ka).
- Dokumentimi i trajnimeve profesionale arsimore (nëse ka).
- Vërtetimi se aplikuesi nuk është në procedurë të hetimeve, apo i dënuar për vepër penale.

UDHËZIM PËR APLIKIM:

Afati i konkurimit është 15 ditë nga data e publikimit dhe mbyllet më datë **13.08.2018**. Për datën dhe orën e testit dhe intervistimit ju njoftojmë menjëherë pas mbylljes së konkursit, në ëëbfaqen e komunes dhe tabelen e shpalljeve. Aplikacionet merren dhe dorëzohen në DKA bashkë me dokumentet e cekura më lart.

Vërejtje : Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen si dhe nuk kthehen pas konkurimit.